

111/24



FKEE

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË
KOSOVSKI FOND ZA ENERGETSKU EFIKASNOST
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND

PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË
KOSOVSKI FOND ZA ENERGETSKU EFIKASNOST
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND

ARRIVI - ARHIVA - ARCHIVE

2183/24

- 3 -

29.11.24

PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA

HANDIK&S

SHOQATA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA - HANDIKOS FERIZAJ
ASSOCIATION OF PERSONS WITH DISABILITY - HANDIKOS FERIZAJ

MARRËVESHJE PËR DONACION

NË MES TË

Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë

DHE

Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuar – Handikos - Ferizaj.

Palët nënshkruese

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE):

FKEE është institucion i pavarur dhe i qëndrueshëm i themeluar me miratimin e Ligjit për Eficiencë të Energjisë në Kosovë. FKEE ka për qëllim arritjen e objektivave të Republikës së Kosovës në fushën e eficiencës së energjisë duke nxitur, mbështetur dhe zbatuar masa e eficiencës së energjisë, si dhe duke menaxhuar burime financiare për të financuar projekte investive në këtë fushë.

Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuar – Handikos - Ferizaj “SH.P.A.K HK – FR” me seli në Ferizaj -Rr. Ramadan Rexhepi Nr.1, me numër të regjistrimit 5115735-4 dhe me numër fiskal 601545166. Visioni i organizatës ka për qëllim të krijoj një shoqëri gjithëpërfshirëse me njohje dhe realizim të plotë të të drejtave dhe mundësive të barabarta të personave me aftësi të kufizuara. Shoqata e personave me aftësi të kufizuar – Handikos Ferizaj është organizatë jo-qeveritare e përkushtuar në rritjen e mirëqenies dhe pavarësimin e personave me aftësi të kufizuar.

Neni 1

Qëllimi

Kjo Marrëveshje për Donacion (‘Marrëveshja’) përcakton kushtet dhe bashkëpunimin e Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE) Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuar – Handikos - Ferizaj “SH.P.A.K HK – FR” me seli në Ferizaj lidhur me projektin për zbatimin e Masave të Eficiencës së Energjisë në ndërtesën e Handikos Ferizaj, me qëllim përmirësimin e kushteve të brendshme termike të ndërtesës, duke kontribuar në uljen e konsumit të energjisë, si dhe reduktimin e kostove operacionale.

Projekti për zbatimin e Masave të Eficiencës së Energjisë do të financohet nga FKEE dhe do të jetë donacion për Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuar – Handikos - Ferizaj “SH.P.A.K HK – FR”

Neni 2

Objekti i Marrëveshjes

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë do të financojë zbatimin projektit për zbatimin e masave të eficiencës së energjisë, për të cilin përlllogaritja e kostos së investimit është 65,000.00 euro, me një devijim potencial prej ±10% të vlerës së parashikuar, projekt ky i cili do të realizohet në tërësi nga FKEE. Procesi i prokurimit, realizimi i projektit dhe mbikëqyrja do të mbulohej nga stafi i FKEE-së, i cili do të garantojë përmbushjen e të gjitha standardeve teknike gjatë procesit të zbatimit.

Gjithashtu, të gjitha procedurat e prokurimit për zbatimin e projektit do të zhvillohen në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

Neni 3 Objektivat

1. Përmirësimi i Efiçencës së Energjisë dhe kursimi i Energjisë:

- Instalimi i sistemit të VRF (Variable Refrigerant Flow) në ndërtesën e Handikos Ferizaj.
- Reduktimi i konsumit të energjisë elektrike dhe termike pas zbatimit të masave.
- Mbrojtje e mjedisit dhe qëndrueshmëria përmes implementimit të masave të efiçencës së energjisë.

2. Përmirësimi i kushteve për personat me aftësi të kufizuara:

- Sigurimi i një ambienti të ngrohtë/freskët, dhe të rehatshëm për përfituesit e shërbimeve të Handikos - Ferizaj.
- Krijimi i kushteve më të mira të punës së personelit të Handikos - Ferizaj.

Neni 4 Rolet dhe Përgjegjësitë e palëve nënshkruese

Fondi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë (FKEE)

- FKEE do të implementojë masat për Efiçencë të Energjisë, sa i përket implementimit të sistemi VRF (Variable Refrigerant Flow) në ndërtesën e Handikos - Ferizaj.
- FKEE fondet për investim për këtë projekt i jep si donacion për Handikos - Ferizaj.
- FKEE do të bëjë zbatimin e projektit si tërësi për implementimin masave, duke zhvilluar të gjitha procedurat për implementimin e projektit për klimatizim efiçient.

Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuar – Handikos - Ferizaj “SH.P.A.K HK – FR”

- Handikos - Ferizaj do të bëjë të gjitha përgatitjet si dhe do të ofrojë mbështetje logjistike dhe administrative për zbatimin e projektit.
- Të bashkëpunojë me FKEE-në në zbatimin e masave të efiçencës së energjisë.
- Të lehtësojë qasjen e personelit teknik dhe specialistëve për të kryer punimet e nevojshme.
- Të zhvillojë aktivitetet e ndërgjegjësimit dhe edukimit për efiçencën e energjisë.
- Të sigurojë mirëmbajtjen e pajisjeve për të siguruar cilësinë dhe funksionalitetin e pajisjeve të instaluar.
- Handikos - Ferizaj obligohet që në rastet e instalimeve të sistemeve të reja apo ndryshimeve të çfardoshme, të cilat do të përfshijnë heqjen e përhershme të pajisjeve të instaluar nga FKEE brenda 5 viteve të ardhshme, të njoftohet FKEE dhe të njëjtat pajisje të mund të përdoren për qëllime të ngjashme.

Neni 5
Afati kohor për implementim

Projekti për implementimin e sistemit të VRF (Variable Refrigerant Flow) do të zbatohet në periudhën kohore brenda 6 muajsh, nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshje.

Neni 6
Koordinimi dhe Komunikimi

Të dyja palët do të caktojnë koordinatore përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj Marrëveshje dhe për të siguruar komunikim efektiv deri në përfundimin e projektit.

Neni 7
Pajtueshmëria Ligjore

Marrëveshja do të zbatohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës.

Neni 8
Ndryshimet

Çdo ndryshim në këtë Marrëveshje duhet të bëhet me shkrim dhe të pranohet nga të dyja palët.

Neni 9
Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lind nga ky raport do të zgjidhet përmes negociatave miqësore. Nëse mosmarrëveshjet nuk zgjidhen përmes negociatave, ato do t'i nënshtrohen legjislacionit në fuqi, dhe do të zgjidhen nga Gjykata Kompetente në Republikën e Kosovës.

Driton Hetemi

Drejtore Menaxhues i FKEE
Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë



Enver Kosumi

Drejtore Ekzekutiv
Handikos Ferizaj
(Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara)



Prishtinë, 29.11.2024